



01 No. 51825 02.09.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit "Bekim Fehmiu" në Prizren, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Alban Krasniqi-aktor, Hajat Toçilla-aktor, Beslidhje Bytyqi -aktore dhe Burim Mustafa -drejtor i TQ "Bekim Fehmiu", për pjesëmarrje në provat zyrtare rreth realizimit të shfaqjes teatrore "In Humane", që është mbajtur nga data 1 gusht 2025 deri me 06 gusht 2025 në Budapest të Republikës së Hungarisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e ushqimit, pagesa e mëditjeve për të lartcekurit dhe shpenzimet tjera.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, TQ "Bekim Fehmiu" dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Teatrit të Qytetit,
 - Arkivës së Kryetarit.